



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE**

Nr. 37 Prot.

Tiranë, më 24. 01. 2022

**Lënda:** Deklarata për cilësinë dhe Gjëndjen e Kontrollit të Brëndshëm në DPM.

**Z.Arlind GJOKUTAJ**  
**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**TIRANË**

Deklarata për Cilësinë dhe kushtet e kontrollit të brëndshëm për vitin 2021 për Dreitorinë e Përgjithshme të Metrologjisë.

**Fusha e përgjegjësisë**

Në cilësinë e NA/Titullarit të njësisë, unë kam përgjegjësinë përmajtjen e një sistemi të shëndoshë të kontrollit të brendshëm, i cili mbështet arrijen e politikave, qëllimeve dhe objektivave të Dreitorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, si dhe mbron fondet publike dhe aktivitet e njësisë publike, përmes cilat unë përgjigjim personalisht, në përpunje me përgjegjësitë që më janë caktuar me anë të Ligjit përmes MFK-në.

**Qëllimi i sistemit të kontrollit të brendshëm**

Sistemi i kontrollit të brëndshëm është ndërtuar kryesisht me qëllim menaxhimin e riskut në një nivel të arsyeshëm, se sa me qëllim eliminimin e të gjitha risqeve që mund të çojnë në dështimin e politikave, qëllimeve dhe objektivave të njësisë; prandaj, ofron vetëm garanci të arsyeshme dhe jo garanci absolute përmes efektivitetit. Sistemi i kontrollit të brendshëm mbështetet në një proces të vazhdueshëm, i ndërtuar përmes identifikuar dhe renditur risqet sipas prioritetit të tyre në raport me arrijen e politikave, qëllimeve dhe objektivave të Dreitorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, përmes vlerësuar probabilitetin e materializimit të këtyre risqeve si dhe impaktin që do të kishin ato, në rast se do të materializoheshin si dhe përmes menaxhimin e tyre efektiv, eficent dhe ekonomik. Sistemi i kontrollit të brendshëm ka funksionuar përmes vitit 2021 deri në momentin e miratimit të raportit vjetor dhe të bilancit si dhe përkon me udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomise.

**Aftësia përmes trajtuar riskun**

[Pëershruani mënyrat kryesore, nëpërmjet të cilave: Procesi i menaxhimit të riskut trajtohet me përparësi;

DPM ka identifikuar, analizuar, vlersuar, trajtuar, monitoruar dhe komunikuar risqet kryesore që shoqërojnë përgjegjësitë e saj, me qëllim minimizimin e ngjarjeve negative të paparashikuara dhe maksimizimin e mundësive. DPM ka hartuar regjistrin e rriskut si dhe strategjinë e tij përmes vitit 2021.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut në DPM është hartuar mbështetur në Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar. DPM konsideron se përmes qëndrimit efektiv, menaxhimi i riskut duhet të bëhet pjesë e kultures së saj e integruar në planet dhe

veprimtaritë e përditshme të punës dhe duhet të bëhet përgjegjesi e çdo punonji në DPM të çdo nivel i deri në hierarkinë më të lartë drejtuse.

**Stafi trajnohet ose pajiset për të menaxhuar riskun, në mënyrë që të përshtatet me përgjegjësitë e secilit.**

Stafi është i trajnuar mjaftushëm për të identifikuar, regjistruar dhe trajtuar risqet, ka një kordinator të emëruar për të hartuar regjistrin e rriskut.

Gjithashtu Përgjegjesi i Sektorit të Menaxhimit te Cilesisë ka hartuar dhe trajnuar Stafin e Laboratorve përrisqet e brëndshme dhe mënyret për ti eliminuar.

**Përfshini komente mbi udhëzimet që u jepen atyre si dhe mbi mënyrat se si juve përpileni të mësoni nga praktikat e mira.]**

Personat përgjegjës përmenaxhimin e riskut, kanë kualifikimin e nevojshëm për identifikimin e riskut dhe përvlersimin e tij, dhe kryejnë trajnime në fushen e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.

Raportohet për çdo lloj ngjarje, si pozitive ashtu dhe negative.

### **Risku dhe kuadri i kontrollit**

[Përshkruani elementët kryesorë të strategjisë së menaxhimit të riskut, duke përfshirë mënyrën se si rishku (ose një ndryshim i tij) identifikohet, vlerësohet dhe kontrollohet.

**Mos harroni të përmendni se si përcaktohet oreksi i riskut.**

Menaxhimi riskut institucional përbëhet nga tetë komponentë të ndërthetur ndërmjet njieri tjetrit. Ata rjedhin nga mënyra se si menaxhimi drejton dhe se si këto elemente janë të integruar me procesin e menaxhimit. Këta elementë janë :

- Ambienti i kontrollit
- Vendasja e objektivave
- Identifikimi risqeve
- Vlerësimi i risqeve
- Përgjigja/reagimi ndaj risqeve
- Veprimtaritë e kontrollit
- Informimi dhe komunikimi
- Monitorimi

**[Përshkruani mënyrat kryesore, se si menaxhimi i riskut është mishëruar në aktivitetin e njësitë.]**

DPM ka përdorur identifikimin e vazhdueshëm të riskut i cili është i nevojshëm për të identifikuar risqe të reja që nuk kanë dalë më parë, ndryshimet në risqet ekzistuese ose risqe ekzistencia e të cilave nuk është më e përshtatshme për DPM-në.

Identifikimi i risqeve i referohet si eksperiencës së kaluar ashtu dhe të ardhmes. Referenca e të kaluarës është fokusuar në raportet vjetore, mangësitë dhe dështimet e së kaluarës dhe raporte të brëndshme.

Misioni, vizioni dhe vlerat janë pjesa e rëndësishme e Strategjisë, të cilat mbështesin dhe tre objektivat strategjikë të DPM-së për periudhën përkatëse si më poshtë;

**Objktivi Nr.1.Zgjerimi i njohjeve ndërkombëtare të DPM-së.**

**Objktivi Nr.2.Realizimi i gjurmushmërisë së matjeve në nivel më të lartë ndërkombëtar.**

**Objktivi Nr.3.Rritja e shkallës së mbrojtjes së konsumatorve**

**[Përshkruaj elementët kryesorë të mënyrave se si aktorët publikë përfshihinë menaxhimin e riskut, që ka impakt mbi ta.]**

### **Rishikimi i efektivitetit**

Në cilësinë e NA/Titullarit të Njësisë Publike, unë jam përgjegjës për rishikimin e efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm. Rishikimi nga ana ime i efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm bëhet në bazë të informimit nga audituesit e brendshëm dhe nga drejtuesit e strukturave të njësisë, të cilët janë përgjegjës për krijimin dhe mbajtjen e kuadrit të kontrollit të brëndshëm në strukturat përkatëse dhe vetë-vlerësimin e funksionimit të kontrolleve të brëndshme, si dhe në bazë të komenteve, të bëra nga audituesit e jashtëm të shprehura në raportet e tyre. Unë jam këshilluar nga GMS rreth pasojave të rezultateve të verifikimit që kam bërë mbi efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe si rrjedhim ekziston një plan për të trajtuar mangësitë e vërejtura në sistem dhe për të garantuar përmirësimin e tij në vazhdimësi.

**[Përviz kruaj proçesin që është zbatuar për të mbajtur dhe për të rishikuar efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë disa elemente mbi rolet;**

Veprimtaritë e kontrollit kryhen në të gjithë DPM-në dhe për të gjitha nivelet dhe funksionete saj, nëpermjet **Kontolleve Parandaluese**, të cilat shërbejnë për të minimizuar mundësinë e riskut që po ndodh (si ndarja e detyrave) Këto kontolle kufizojnë mundësinë e një rezultati të padëshiruar. Kontrollet parandaluese përfshijnë ndarjen e detyrave, kufizimi i veprimeve të personave të autorizuar (psh, vetëm ata që janë trajnuar dhe autorizuar lejohen të kryejnë veprimitari të caktuara). Synimi i tyre është parandalimi i ndodhjes së riskut përkatës dhe rritja e sigurisë se objektivat do të arrihen. Në këtë kontekst është hartuar rregullorja e brëndshme.

#### **Grupit për Menaxhimin Strategjik dhe të koordinatorit të riskut.**

Në DPM fuksionon grupi i Menaxhimit Strategjik i cili mblidhet rast pas rasti sipas nevojave.

#### **Auditimit të brëndshëm.**

Në DPM nuk ka strukture Auditit të brëndshëm, auditohemi nga Drejtoria e Auditit të Brëndshëm të MFE.

#### **Mekanizma të tjerë garantues/të verifikimeve formale, përfshirë edhe vetëvlerësimin mbi kontrollin e brëndshëm.**

Mbështetur në sa më sipër DPM ka adoptuar dhe ndjekur politika dhe procedura që adresojnë risqet kryesore si më poshtë:

Kontrollet Buxhetore dhe kontolle të tjera financiare: përdorimi i buxheteve dhe limiteve të deleguara për disa kategori shpenzimesh dhe kontolle të tjera të kontabilitetit duhet të sigurojë se shpenzimet janë aprovuar saktë dhe kontabilizuar saktë nga menaxheri përgjegjës. Kjo duhet të kufizojë qëllimin për mashtrim dhe mund të rezultojë në disa lloje mashtrimesh që mund të zbulohen.

Kontolle të zbatimit të standarteve ndërkombëtare në fushën e Metrologjisë në laboratoret e DPM-së, nga sektori i menaxhimit të cilësisë në DPM.

**Datë 06.01.2022.**

Ju faleminderit.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

